TRAINKOS SH.A.
TRAINKOS D.D.
TRAINKOS J.S.C.
Nr.No.Br. I/14
Dt. 27.02.2023
Fushë Kosovë - Fushë Kosova - Kosovo Polje
trainkos

HEKURUDHAT E KOSOVËS TRAINKOS SH. A.

2022

RAPORT

Tetor - Dhjetor 2022



FUSHË KOSOVË,

Janar 2023

PËRMBAJTJA

I.	HYRJE ……	3
II.	STRUKTURA ORGANIZATIVE E HK – TRAINKOS SH. A. ……...	4
III.	TREGUESIT E RAPORTIT FINANCIAR …….	6
III.1	Gjendja financiare Tetor – Dhjetor 2022 ……..……..	6
III.1.1	Të hyrat ……...	6
III.1.2	Shpenzimet ……..	7
III.2	Gjendja në para të gatshme – Raporti sipas bankës (31.12.2022) …….	13
III.3	Transaksionet e realizuara (Tetor – Dhjetor 2022) …….....	13
III.4	Bilanci i Gjendjes (Tetor – Dhjetor 2022)	14
IV.	DEPARTAMENTI I TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE …….....	15
IV.1	Pasqyra e performancës operative ……..	15
IV.2	Organizimi dhe realizimi i transportit të udhëtarëve …….	15
IV.3	Numri i trenave, tren kilometër (T/km) dhe udhëtarë kilometër (U/km) …….	16
IV.4	Vonesat e trenave të udhëtarëve ……...	16
V.	DEPARTAMENTI I TRANSPORTIT TË MALLRAVE ……..	17
V.1	Pasqyra e performancës operative.…….....	17
V.2	Rezultatet e arritura nga transporti i mallrave ……...	17
V.3	Shfrytëzimi i Trenave …….	20
V.4	Efektiviteti i Trenave	20
V.5	Neto Ton & Neto Ton Kilometër të transportuar ……...	20
V.6	Mallrat e transportuara …….	20
V.7	Revokimi i Trenave	21
VI.	ZYRA E MIRËMBAJTJES SË MJETEVE LËVIZËSE – MML …….	22
VI.1	Pasqyra e performancës operative …….....	22
VI.2	Sektori i mirëmbajtjes …….....	22
VII.	DEPARTAMENTI I PROKURIMIT…….....	25
VII.1	Projektet kapitale …….....	25
VIII.	ZYRA LIGJORE …….....	26
VIII.1	Kontestet për Kompensim Dëmi ..…….	26
VIII.2	Kontestet nga Mardhanja e Punës	28
VIII.3	Kontestet nga Konflikti Administrativ	30
VIII.4	Kontestet për Pagim Borgji	30
VIII.5	Lëndët në Procedurë Përmbarimore	31
IX.	DEPARTAMENTI I ZHVILLIMIT TË BIZNESIT ……..	34
IX.1	Planifikimi dhe Zhvillimi i Biznesit ……..	34
IX.2	Koordinimi i proceseve me MMPHI, ARH-në dhe Institucionet tjera relevante ....…	36
IX.3	Aktivitet e Marketingut …….	37
IX.4	Raportimi i rregullt në Asociacionet Hekurudhore dhe Sekretariatin për zbatimin e Traktatit për Transport …….....	38
IX.5	Shqyrtimi i mundësive për kryerjen e veprimtarisë – shpedicion për klientët e TRAINKOS-it	38
X.	SFIDAT KRYESORE GJATË PERIUDHËS TETOR – DHJETOR 2022 DHE VEPRIMET PËR TË ARDHMEN ……...	39

I. HYRJE

Raporti për periudhën Tetor - Dhjetor 2022, për HK – "Trainkos" SH. A. është karakterizuar kryesisht më përpjekjen e të gjitha niveleve organizative të kompanisë duke filluar nga Bordi i Drejtorëve, Menaxhmenti e deri te stafi ekzekutiv për arritjen e rezultateve më pozitive në kushtet dhe mundësitë ekzistuese.

Ky raport paraqet qartë aktivitetet gjatë këtij tremujori (tetor - dhjetor 2022) në funksion të arritjes së objektivave të vendosura me Planin e Biznesit. Po ashtu në këtë raport pasqyrohen vështirësitë dhe sfidat gjatë zhvillimit të aktivitetit të kompanisë për këtë tremujor, sfida këto që përcillen nga periudhat paraprake e që ndikojnë drejtpërdrejt në (mos) arritjen e planifikimeve.


Sfidat për këtë periudhë kanë qenë nga më të ndryshmet, duke u përballur me të gjitha vështirësitë që vijnë si rezultat i mungesës së kërkesës në treg, veçanërisht atyre të transportit të mallrave dhe në anën tjetër me një konkurrencë të egër nga operatorë të transportit rrugorë të mallrave.

Sikurse gjatë periudhave të kaluara, edhe gjatë këtij tremujori (tetor - dhjetor 2022) problem në vete vazhdojnë të jenë: pengesat në qarkullimin e trenave në tërë linjat ekzistuese hekurudhore dhe veçanërisht qarkullimi në linjën Fushë Kosovë – Hani i Elezit e cila për shkak të punimeve që po bëhen në këtë segment (Modernizimi i Linjës së 10-të hekurudhore) si lidhje e vetme hekurudhore e vendit me portin e Selanikut, neve si kompani na ka pa mundësuar realizimin e transportit të paraparë sipas Planit të Biznesit.

Transporti i udhëtarëve në Linjën Prishtinë – Pejë dhe anasjelltas vazhdon të bëhet me shumë vështirësi, kjo për shkak të vjetërisë dhe gjendjes jo e mirë të mjeteve tërheqëse dhe të tërhequra, ndërsa Linja për Shkup (Maqedoni e Veriut) nuk është lëshuar akoma në qarkullim për shkak të "Rehabilitimin e pjesës Jugore të Linjës së 10-të Hekurudhore, Fushë Kosovë – Hani i Elezit". Kjo ndërprerje e qarkullimit do të vazhdoj deri në rehabilitimin e plot të këtij segmenti hekurudhor.

II. STRUKTURA ORGANIZATIVE E HK – TRAINKOS SH. A.

Hekurudhat e Kosovës - Trainkos SH. A. brenda periudhës Tetor – Dhjetor 2022 në numrin e përgjithshëm të të punësuarve ka pasur disa ndryshime të cilat kanë reflektuar edhe në përqindjen e strukturës së përgjithshme të të punësuarve. Në tabelën në vijim do të paraqesim gjendjen e të punësuarve në Kompani nga data 01.10.2022 deri më 31.12.2022, duke filluar nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, mosha mesatare, punëtorët me kontrata të afatizuara dhe të pa afatizuara etj.



Paraqitja statistikore për llojet e kontratave, mosha e të punësuarve, struktura gjinore, struktura nacionale dhe kualifikimi shkollor i të punësuarve në HK-Trainkos - SH. A. është si vijon:

Struktura e të punësuarve në bazë të kategorizimeve të HK-Trainkos -SH.A. më 1 Tetor 2022 dhe më 31 Dhjetor 2022					
Totali i të punësuarve	01.10.2022		31.12.2022		
	215		211		
Vlerat	Vlerat në numra		Vlerat në përqindje		
Datat	01.10.2022	31.12.2022	01.10.2022	31.12.2022	
Mosha mesatare e punëtorëve	46.99	46.96	%	%	
Me marrëdhënie të rregullt pune	215	211	%	%	Format e kontratave
Me kontratë të pa afatizuar	58	53	26.97%	25.11 %	
Me kontratë të afatizuar	157	158	73.02 %	74.88 %	
Meshkuj	188	183	87.44 %	86.72 %	Naci Gjini onalja
Femra	27	27	12.55 %	13.27 %	
Serb	2	2	0.93 %	0.94 %	
Shqiptarë	213	209	99.06 %	99.05 %	
Me shkollim fillor	7	5	3.25%	2.36 %	Shkollimi
Shkollim të mesëm	116	114	53.95 %	54.02 %	
Kualifikim profesional	22	22	10.23 %	10.42 %	
Me shkollim të lartë	2	2	0.93 %	0.94 %	
Me shkollim superior	68	68	31.62 %	32.22 %	
Zyrtarët e Lartë	4	5	1.86 %	2.36 %	Përshkrimi i Departamenteve
Departamenti i Transportit të Mallrave	47	46	21.86 %	21.80 %	
Departamenti i Transportit të Udhëtarëve	56	56	26.04 %	26.54 %	
Departamenti i Administratës	48	46	22.32 %	21.80 %	
Departamenti i Financave	8	7	3.72 %	3.31 %	
Departamenti i Zhvillimit	5	5	2.32 %	2.36 %	
Departamenti i Prokurimit	4	4	1.86 %	1.89%	
Kabineti i KE-së	3	2	1.39 %	0.94%	Kabineti i KE-së dhe
Zyra e Kontrollit, Sigurisë dhe Kualitetit	19	19	8.83 %	9.00 %	
Zyra për Marrëdhënie me Publikun	1	1	0.46 %	0.47 %	
Zyra Ligjore	3	3	1.39 %	1.42 %	
Zyra e Mirëmbajtjes	17	17	7.90 %	8.05 %	

Tabela Nr. 2.1

Sqarim:

Në tabelën e cekur më lartë nuk janë përfshirë anëtarët e Bordit të Drejtorëve.

Sqarim i tabelës së lartcekur:

- Totali i të punësuarve me 01.10.2022 është 215 të punësuar.
- Totali i të punësuarve me 31.12.2022 është 211 të punësuar.

III. TREGUESIT E RAPORTIT FINANCIAR

1. Gjendja financiare (tetor – dhjetor 2022)
2. Gjendja në para të gatshme - raporti sipas bankës (31.12.2022)
3. Transaksionet e realizuara (tetor – dhjetor 2022)
4. Bilanci i Gjendjes (tetor – dhjetor 2022)

III. 1 Gjendja financiare tetor – dhjetor 2022

Për periudhën raportuese tetor – dhjetor 2022, gjendja e pozicioneve të të hyrave dhe shpenzime është siç vijon:

III. 1.1. Të hyrat

Nga **Transporti i mallrave** nuk kemi realizuar të hyrat për periudhën tetor - dhjetor 2022. Totali i të hyrave të planifikuara për vitin 2022, është 929,796.87€ dhe nga kjo del se kemi realizuar 0.00% nga totali.

Transporti i udhëtarëve për periudhën tetor – dhjetor 2022, është realizuar në shumën prej 456,184.02 €. Nga të hyrat e faturuara nga Transporti i Kontraktuar janë 270,548.33 €, nga të hyrat e planifikuara nga subvencioni për mbulimin e pjesshëm të humbjeve nga trenat tjerë të udhëtarëve kemi realizuar shumën prej 169,567.23 €. Burimi i të ardhurave nga biletat është realizuar në shumën prej 16,068.46 €, shprehur në përqindje më realizimin e të hyrave nga transporti i udhëtarëve kemi arritur shumën e realizimit 22.47%, krahasuar me planifikimet e vitit 2022 – 2,030,275.00 €.

Të hyrat nga shërbimet tjera gjatë periudhës tetor - dhjetor 2022, kanë arritur shumën prej 2,008.47 €. Kjo shumë nëse krahasohet me shumën e buxhetuar për vitin 2022, e cila është 50,000.00 € arrin kuotën prej 4.02 %. Kjo e hyrë është realizuar në pozicionin të hyrat nga RIV-i dhe vendosjet dhe kontrata me kompaninë GCF.

Të hyra tjera të cilat janë realizuar gjatë periudhës tetor – dhjetor 2022, kanë arritur shumën prej 20,825.89 €. Kjo e hyrë është realizuar në pozicionet siç vijojnë: Të hyrat nga shitja e derivateve për HK-Infrakos Sh. A. – 2,008.47 € dhe të hyrat nga dëmtimi i vagonëve, kompensim i dëmit për vetura dhe kompensim i dëmit nga GCF në vlerë totale prej 13,138.00. Buxheti i planifikuar është 90,000.00 €, shprehur në përqindjen 23.14 %.

Të hyrat e realizuar gjatë kësaj periudhe janë jo të kënaqeshe, arsyeja e mos realizimit të planifikuar është si pasojë e rregullimit të Linjës së Dhjetë Hekurudhore nga HK Infrakos Sh. A, e cila ka ndikuar negativisht në realizimit e të hyrave për Trainkos Sh. A, gjithashtu edhe ndërprerja e transportit vendor nga klienti ynë kryesor, NewCo Ferronikel, ka ndikuar në mos realizimin e të hyrave.

III. 1.2. Shpenzimet

Shpenzimet për periudhën tetor–dhjetor 2022, ashtu edhe siç janë buxhetuar janë të klasifikuara në kategoritë që pasojnë:

Totali i kostos së shërbimit për periudhën është 164,176.53 € nga 944,500.00 € të planifikuara për vitin 2022 dhe arrijnë kuotën prej 17.38 %. Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën më poshtë – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën tetor – dhjetor 2022.

Shpenzimet e stafit është kategori tjetër e rëndësishme e cila ka arritur shumën prej 410,499.30 €, dhe atë në paga dhe kontribute 410,339.30 € dhe sigurimi shëndetësor, trajnime dhe shpenzime tjera në vlerë prej 160.00 €. Në total nëse e krahasojmë shumën e buxhetuar për vitin 2022 – 1,934,000.00 €, në këtë kategori kemi arritur kuotën prej 21.23 %.

Totali i shpenzimeve operative kap shumën prej 96,331.30 €, kjo shumë është vetëm 79.61% nga shuma prej 121,000.00 € e parashikuar vitin 2022. Edhe kjo kategori e shpenzimeve sipas grupimeve në kode të posaçme është e precizuar në tabelën e më poshtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën tetor – dhjetor 2022.

Totali i shpenzimeve administrative ka arritur në kuotën prej 19.27 %, konkretisht në shumën prej 18,887.54 €. Planifikimi për vitin 2022, i kësaj kategorie është 98,000.00 €. Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën e mëposhtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën tetor – dhjetor 2022.


Të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën Tetor – Dhjetor 2022 2022

	EMËRTIMI	Realizimi Tetor-Dhjetor 2022	Buxheti 2022	Diferenca	B/C (%)	Realizimi Tetor-Dhjetor 2021
	A	B	C	D	E	F
A	Shitjet					
1	Transporti i mallrave	-	929,796.87	(929,796.87)	-	58,722.55
2	TU – Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastruktures	270,548.33	1,350,000.00	(1,079,451.67)	20.04	251,893.85
3	TU – Ministria e Zhvillimit Ekonomik	169,567.23	610,275.00	(440,707.77)	27.79	144,069.51
4	TU – Shitja e Biletave	16,068.46	70,000.00	(53,931.54)	22.95	12,766.29
5	Shërbimet tjera	2,008.47	50,000.00	(47,991.53)	4.02	7,063.88
6	Të ardhurat – Dëmtimi i vagonave	13,138.00	70,000.00	(56,862.00)	18.77	160.00
7	Të hyrat tjera jo operative	7,687.89	20,000.00	(12,312.11)	38.44	7,331.05
I	TOTAL – TË HYRAT	479,018.38	3,100,071.87	(2,621,053.49)	15.45	482,007.13
B	Kostoja e shërbimit/blerjes së materialeve					
1	Derivatet dhe lubrifikantet	102,691.73	465,000.00	(362,308.27)	22.08	102,072.96
2	Energjia elektrike dhe shërbimet tjera komunale	7,842.11	25,500.00	(17,657.89)	30.75	8,168.34
3	Inventar dhe pajisje	194.74	3,000.00	(2,805.26)	6.49	317.79
4	Material harxhues	-	1,000.00	(1,000.00)	-	2,196.61
5	Pjesë rezervë/mirëmbajtje dhe materiale tjera	5,039.06	60,000.00	(54,960.94)	8.40	4,622.07
6	Qasja në binarë	43,185.79	320,000.00	(276,814.21)	13.50	58,268.91
7	Sigurimi i palëve të treta	-	3,000.00	(3,000.00)	-	-
8	Tërheqja e trenave dhe qiraja e vagonëve të huaj	-	42,000.00	(42,000.00)	-	118,099.28
9	Shpenzimet e transportit Infrakos	6,894.86	20,000.00	(13,105.14)	34.47	7,261.02
10	Servisimi i arkave fiskale	-	5,000.00	(5,000.00)	-	-
11	Mosperputhje e stokut	(2,977.76)	-	(2,977.76)	-	-
12	Zbritjet e lejuara	1,306.00	-	1,306.00	-	-
	TOTAL – KOSTOJA E SHERBIMIT	164,176.53	944,500.00	(780,323.47)	17.38	301,006.98
	Fitimi (humbja) bruto	314,841.85	2,155,571.87	(1,840,730.02)	14.61	181,000.15
	TË ARDHURAT TJERA					
1	Të Ardhura të jashtëzakonshme	-	-	-	-	-
2	Të hyrat e shtyra (shpenzimet)	9,414.32	-	9,414.32	-	-
3	Të hyrat nga shitja e skrapit (shitja e aseteve)	-	-	-	-	-
4	Te ardhura tjera	-	-	-	-	-
	TOTAL – Të ardhurat tjera	9,414.32	-	9,414.32	-	-
C	Shpenzimet e stafit					
1	Pagat dhe kontributet	410,339.30	1,925,000.00	(1,514,660.70)	21.32	435,428.02
2	Sigurimi shendetsor, trajnime dhe Shpenzime tjera	160.00	9,000.00	(8,840.00)	1.78	-
	TOTAL - Shpenzimet e stafit	410,499.30	1,934,000.00	(1,523,500.70)	21.23	435,428.02
D	Shpenzimet operative					
1	Mirëmbajtje dhe riparime	2,949.61	10,000.00	(7,050.39)	29.50	5,297.46
2	Sigurimi fizik – total	-	-	-	-	-
3	Shërbimet tjera	-	-	-	-	-

4	Shpenzimet logjistike	10,914.98	22,000.00	(11,085.02)	49.61	11,009.48
5	Energjia elektrike dhe komunalite	1,658.00	7,500.00	(5,842.00)	22.11	1,433.82
6	Kontrollimet sistematike	1,250.00	2,000.00	(750.00)	62.50	1,550.00
7	Marketingu	2,454.40	11,000.00	(8,545.60)	22.31	952.00
8	Udhëtimet zyrtare	-	1,000.00	(1,000.00)	-	-
9	Telefonat dhe Posta	3,143.26	17,500.00	(14,356.74)	17.96	3,067.56
10	Shërbimet bankare	301.49	1,000.00	(698.51)	30.15	206.54
11	Tatimet	71,311.57	42,000.00	29,311.57	169.79	49,732.47
12	Pajisje elektronike	599.21	7,000.00	(6,400.79)	8.56	1,865.19
13	Shpenzimet e interesit të kredisë	1,748.78	-	1,748.78	-	-
	TOTAL - Shpenzimet operative	**96,331.30**	**121,000.00**	**(24,668.70)**	**79.61**	**75,114.52**
E	**Shpenzimet administrative**					
1	Inventar dhe pajisje	-	5,000.00	(5,000.00)	-	685.12
2	Konsulenca dhe auditimi i jashtëm	1,507.44	10,000.00	(8,492.56)	15.07	825.00
3	Material i zyrës	4,170.96	21,000.00	(16,829.04)	19.86	2,283.68
4	Material sanitar	457.54	7,000.00	(6,542.46)	6.54	463.68
5	Qiraja për objektet	3,960.85	15,000.00	(11,039.15)	26.41	3,764.16
6	Reprezentacioni dhe bufeja	540.64	6,000.00	(5,459.36)	9.01	886.54
7	Shpenzimet gjyqësore dhe ndëshkimet	3,852.00	5,000.00	(1,148.00)	77.04	427.80
8	Shpenzimet logjistike	3,318.11	19,000.00	(15,681.89)	17.46	9,367.48
9	Kontigjente	1,080.00	10,000.00	(8,920.00)	10.80	352.01
	TOTAL - shpenzimet administrative	**18,887.54**	**98,000.00**	**(79,112.46)**	**19.27**	**19,055.47**
	Provizionet e borgjeve të këqija	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**
II	**TOTAL -SHPENZIMET (B+C+D+E)**	**689,894.67**	**3,097,500.00**	**(2,407,605.33)**	**22.27**	**830,604.99**
	Provizionimi i llogarive të arktueshme	**7,596.45**	**-**	**7,596.45**	**-**	**-**
III	**Fitimi (Humbja) para zhvlersimit**	**(209,058.42)**	**2,571.87**	**(211,630.29)**	**(8,128.65)**	**(348,597.86)**
	GRANTET	**114,614.46**	**570,000.00**	**(455,385.54)**	**20.11**	**189,277.54**
F	**Shpenzimet e zhvlerësimit**		**-**			
1	**Shpenzimet e zhvlerësimit që janë rezultat i granteve**	**114,614.46**	**570,000.00**	**(455,385.54)**	**20.11**	**189,277.54**
2	**Shpenzimet e zhvlerësimit që janë nga buxheti i kompanisë**	**12,231.58**	**30,000.00**	**(17,768.42)**	**40.77**	**5,853.94**
	TOTAL - shpenzime e zhvlerësimit	**126,846.04**	**600,000.00**	**(473,153.96)**	**21.14**	**195,131.48**
G	**Fitimi (humbja) nga veprimtaria**	**(221,290.00)**	**(27,428.13)**	**(193,861.87)**	**806.80**	**(354,451.80)**


Tabela Nr. 3.1

Pjesëmarrja e të hyrave sipas llojit të shërbimit Tetor – Dhjetor 2022



Diagrami Nr. 3.1

Pjesëmarrja e shpenzimeve sipas kategorive Tetor – Dhjetor 2022



Diagrami Nr.3.2

Raporti i performancës financiare TM3-TM4 2022 dhe TM4 2021

	EMËRTIMI	Realizimi TM4 2022	Realizimi TM3 2022	Diferenca TM4-TM3 2022	(%) TM4-TM3 2022	Realizimi TM4 2021	Diferenca TM4 2022-2021	(%) TM4 2022-2021
	A	B	C	D	E	F	G	H
A	**Shitjet**							
1	**Transporti i mallrave**	-	110,364.83	(110,364.83)	-	58,722.55	(58,722.55)	-
2	**TU – Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastruktures**	270,548.33	233,540.65	37,007.68	13.68	251,893.85	18,654.48	6.90
3	**TU – Ministria e Ekonomisë**	169,567.23	152,568.75	16,998.48	10.02	144,069.51	25,497.72	15.04
4	**TU – Shitja e Biletave**	16,068.46	15,834.80	233.66	1.45	12,766.29	3,302.17	20.55
5	**Shërbimet tjera**	2,008.47	5,357.75	(3,349.28)	(166.76)	7,063.88	(5,055.41)	(251.70)
6	**Të ardhurat – Dëmtimi i vagonave**	13,138.00	130.00	13,008.00	99.01	160.00	12,978.00	98.78
7	**Të hyrat tjera jo operative**	7,687.89	9,436.66	(1,748.77)	(22.75)	7,331.05	356.84	4.64
I	**TOTAL – TË HYRAT**	**479,018.38**	**527,233.44**	**(48,215.06)**	**(10.07)**	**482,007.13**	**(2,988.75)**	**(0.62)**
B	**Kostoja e shërbimit/blerjes së materialeve**							
1	**Derivatet dhe lubrifikantet**	102,691.73	126,027.97	(23,336.24)	(22.72)	102,072.96	618.77	0.60
2	**Energjia elektrike dhe shërbimet tjera komunale**	7,842.11	2,451.50	5,390.61	68.74	8,168.34	(326.23)	(4.16)
3	**Inventar dhe pajisje**	194.74	223.12	(28.38)	(14.57)	317.79	(123.05)	(63.19)
4	**Material harxhues**	-	-	-	-	2,196.61	-	-
5	**Pjesë rezervë/mirëmbajtje dhe materiale tjera**	5,039.06	3,192.28	1,846.78	36.65	4,622.07	416.99	8.28
6	**Qasja në binarë**	43,185.79	66,368.24	(23,182.45)	(53.68)	58,268.91	(15,083.12)	(34.93)
7	**Sigurimi i palëve të treta**	-	3,384.00	(3,384.00)	-	-	-	-
8	**Tërheqja e trenave dhe qiraja e vagonëve të huaj**	-	147.30	(147.30)	-	118,099.28	-	-
9	**Shpenzimet e transportit Infrakos**	6,894.86	9,589.83	(2,694.97)	(39.09)	7,261.02	(366.16)	(5.31)
10	**Servisimi i arkave fiskale**	-	-	-	-	-	-	-
11	**Mosperputhje e stokut**	(2,977.76)	-	(2,977.76)	100.00	-	(2,977.76)	100.00
12	**Zbritjet e lejuara**	1,306.00	-	1,306.00	100.00	-	1,306.00	100.00
	TOTAL – KOSTOJA E SHERBIMIT	**164,176.53**	**211,384.24**	**(47,207.71)**	**(28.75)**	**301,006.98**	**(136,830.45)**	**(83.34)**
	Fitimi (humbja) bruto	314,841.85	315,849.20	(1,007.35)	(0.32)	181,000.15	133,841.70	42.51
	TË ARDHURAT TJERA							
1	**Të Ardhura të jashtëzakonshme**	-	-	-	-	-	-	-
2	**Të hyrat e shtyra (shpenzimet)**	9,414.32	-	9,414.32	100.00	-	9,414.32	100.00
3	**Të hyrat nga shitja e skrapit (shitja e aseteve)**	-	-	-	-	-	-	-
4	**Të ardhura tjera**	-	31,161.32	(31,161.32)	-	-	-	-
	TOTAL – Te ardhurat tjera	**9,414.32**	**31,161.32**	**(21,747.00)**	**(231.00)**	**-**	**9,414.32**	**100.00**
C	**Shpenzimet e stafit**							
1	**Pagat dhe kontributet**	410,339.30	417,259.37	(6,920.07)	(1.69)	435,428.02	(25,088.72)	(6.11)
2	**Sigurimi shendetsor, trajnime dhe Shpenzime tjera**	160.00	250.00	(90.00)	(56.25)	-	160.00	100.00
	TOTAL - Shpenzimet e stafit	**410,499.30**	**417,509.37**	**(7,010.07)**	**(1.71)**	**435,428.02**	**(24,928.72)**	**(6.07)**

D	**Shpenzimet operative**							
1	**Mirëmbajtje dhe riparime**	2,949.61	1,743.67	1,205.94	40.88	5,297.46	(2,347.85)	(79.60)
2	**Sigurimi fizik – total**	-	-	-	-	-	-	-
3	**Shërbimet tjera**	-	-	-	-	-	-	-
4	**Shpenzimet logjistike**	10,914.98	4,697.79	6,217.19	56.96	11,009.48	(94.50)	(0.87)
5	**Energjia elektrike dhe komunalite**	1,658.00	1,383.71	274.29	16.54	1,433.82	224.18	13.52
6	**Kontrollimet sistematike**	1,250.00	-	1,250.00	100.00	1,550.00	(300.00)	(24.00)
7	**Marketingu**	2,454.40	204.40	2,250.00	91.67	952.00	1,502.40	61.21
8	**Udhëtimet zyrtare**	-	-	-	-	-	-	-
9	**Telefonat dhe Posta**	3,143.26	4,163.54	(1,020.28)	(32.46)	3,067.56	75.70	2.41
10	**Shërbimet bankare**	301.49	95.60	205.89	68.29	206.54	94.95	31.49
11	**Tatimet**	71,311.57	-	71,311.57	100.00	49,732.47	21,579.10	30.26
12	**Pajisje elektronike**	599.21	580.14	19.07	3.18	1,865.19	(1,265.98)	(211.27)
13	**Shpenzimet e interesit të kredisë**	1,748.78	-	1,748.78	100.00	-	1,748.78	100.00
	TOTAL - Shpenzimet operative	**96,331.30**	**12,868.85**	**83,462.45**	**86.64**	**75,114.52**	**21,216.78**	**22.02**
E	**Shpenzimet administrative**							
1	**Inventar dhe pajisje**	-	-	-	-	685.12	(685.12)	-
2	**Konsulenca dhe auditimi i jashtëm**	1,507.44	4,777.82	(3,270.38)	(216.95)	825.00	682.44	45.27
3	**Material i zyrës**	4,170.96	1,883.59	2,287.37	54.84	2,283.68	1,887.28	45.25
4	**Material sanitar**	457.54	728.71	(271.17)	(59.27)	463.68	(6.14)	(1.34)
5	**Qiraja për objektet**	3,960.85	2,920.67	1,040.18	26.26	3,764.16	196.69	4.97
6	**Reprezentacioni dhe bufeja**	540.64	555.82	(15.18)	(2.81)	886.54	(345.90)	(63.98)
7	**Shpenzimet gjyqësore dhe ndëshkimet**	3,852.00	1,868.22	1,983.78	51.50	427.80	3,424.20	88.89
8	**Shpenzimet logjistike**	3,318.11	2,128.66	1,189.45	35.85	9,367.48	(6,049.37)	(182.31)
9	**Kontigjente**	1,080.00	-	1,080.00	100.00	352.01	727.99	67.41
	TOTAL - shpenzimet administrative	**18,887.54**	**14,863.49**	**4,024.05**	**21.31**	**19,055.47**	**(167.93)**	**(0.89)**
	Provizionet e borgjeve të këqija	-	-	-	-	-	-	-
II	**TOTAL -SHPENZIMET (B+C+D+E)**	**689,894.67**	**656,625.95**	**33,268.72**	**4.82**	**830,604.99**	**(140,710.32)**	**(20.40)**
	Provizionimi i llogarive të arktueshme	**7,596.45**	**-**	**7,596.45**	**-**	**-**	**7,596.45**	**100.00**
III	**Fitimi (Humbja) para zhvlersimit**	**(209,058.42)**	**(98,231.19)**	**(110,827.23)**	**46.99**	**(348,597.86)**	**139,539.44**	**(66.75)**
	GRANTET	**114,614.46**	**122,851.64**	**(8,237.18)**	**(7.19)**	**189,277.54**	**(74,663.08)**	**(65.14)**
F	**Shpenzimet e zhvlerësimit**		**-**					
1	**Shpenzimet e zhvlerësimit që janë rezultat i granteve**	**114,614.46**	**122,851.64**	**(8,237.18)**	**(7.19)**	**189,277.54**	**(74,663.08)**	**(65.14)**
2	**Shpenzimet e zhvlerësimit që janë nga buxheti i kompanisë**	**12,231.58**	**12,231.58**	**-**	**-**	**5,853.94**	**6,377.64**	**52.14**
	TOTAL - shpenzime e zhvlerësimit	**126,846.04**	**135,083.22**	**(8,237.18)**	**(6.49)**	**195,131.48**	**(68,285.44)**	**(53.83)**
G	**Fitimi (humbja) nga veprimtaria**	**(221,290.00)**	**(110,462.77)**	**(110,827.23)**	**50.08**	**(354,451.80)**	**133,161.80**	**(60.18)**

Tabela Nr. 3.2

III.2. Gjendja në para të gatshme – Raporti sipas bankës (31.12.2022)

Nr.	EMËRTIMI	Saldo 31-12-2022
1	PCB nr. 1114-004229-0001-59	297,866.53
2	PCB (KTh) nr. 1114-004229-0101-50	0.00
3	BKK - PCB (K) nr. 1114-004229-0201-41	531.87
4	BKK - PCB (S) nr. 1114-004229-0301-32	68,610.15
5	BKK - PCB (M) nr. 1114-004229-0401-23	343,634.16
6	GH-PCB nr. 1114004229040114	87.52
	TOTALI	**710,730.23**

Tabela Nr. 3.3

III.3. Transaksionet e realizuara (Tetor – Dhjetor 2022)

Në tabelat në vijim janë paraqitur transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse dhe ato në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës:

Transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.10.2022	236,185.12
Inkasimet e pranuara gjatë muajve tetor– dhjetor 2022	139,852.73
Pagesat e kryera gjatë muajve tetor– dhjetor 2022	78,171.32
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.12.2022	297,866.53

Tabela Nr. 3.4

Transaksionet në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.10.2022	539.37
Inkasimet e pranuara gjatë muajve tetor – dhjetor 2022	218,313.52
Pagesat e kryera gjatë muajve tetor – dhjetor 2022	218,321.02
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.12.2022	531.87

Tabela Nr. 3.5

Transaksionet e kompanisë nga subvencionet (MI dhe ME)	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.10.2022	10.66
Inkasimet e pranuara gjatë muajve tetor – dhjetor 2022	994,048.75
Pagesat e kryera gjatë muajve tetor – dhjetor 2022	581,815.10
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.12.2022	412,244.31

Tabela Nr. 3.6

Në tabelën më poshtë janë paraqitur transaksionet më të mëdha gjatë periudhës Tetor – Dhjetor 2022 për deponimet dhe pagesat:

Deponimet Tetor - Dhjetor 2022			Pagesat Tetor - Dhjetor 2022		
1	Të hyra nga Ministria e Ekonomisë	610,275.00	1	Shpenzimet e pagave	344,852.33
2	Të hyrat nga MMPHI	383,773.75	2	Shpenzimet për investime kapitale	218,831.02
3	Të hyrat nga BK për Investime Kapitale	218,313.52	3	Shpenzimet për Infrakos	96,891.84
4	Të hyrat nga Transporti i Mallrave	120,265.51	4	Shpenzimet e derivateve	79,403.12
5	Të hyra nga Transporti i udhëtarëve	17,490.00	5	Shpenzimet për ATK	64,594.59
TOTALI		**1,350,117.78**	**TOTALI**		**804,572.90**

Tabela Nr. 3.7

III.4. Bilanci i Gjendjes (Tetor – Dhjetor 2022)

BILANCI I GJENDJES		
NP TRAINKOS SH.A.	**GJENDJA FILLESTARE 01/10/2022**	**GJENDJA PERFUNDIMTARE 31.12.2022**
Mjetet themelore - vlera neto sipas librave	**2,471,262.97**	**2,440,607.65**
Mjetet Qarkulluese	**2,481,895.29**	**1,930,106.83**
Stoqet	413,699.28	426,548.91
Paraja	247,926.89	711,382.59
Llogarite e arketueshme	1,384,825.00	752,049.16
Kerkesa tjera te arketushme	414,858.88	30,386.55
Parapagimet	20,585.24	9,739.62
Total Mjetet Qarkulluese dhe themelore	**4,953,158.26**	**4,370,714.48**
Detyrimet afatshkurta	**2,073,887.59**	**2,049,681.17**
Llogarite e pagueshme	962,014.44	886,770.10
Të pagueshme tjera - detyrime	1,140.53	1,351.49
Detyrime tatimore	745,769.62	796,596.58
Detyrimet e kredisë	364,963.00	364,963.00
Detyrimet afatgjata	**316,474.47**	**1,631,317.93**
Kapitali	**5,293,680.81**	**5,289,481.93**
Fitimi/Humbja e bartur	(2,232,261.73)	(3,907,393.93)
Fitim/ Humbja e vitit	(498,622.88)	(692,372.11)
Total detyrimet dhe kaptali	**4,953,158.26**	**4,370,714.48**

Tabela Nr. 3.8

IV. DEPARTAMENTI I TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE

IV.1 Pasqyra e performancës operative

Në këtë pjesë të raportit do të paraqesim përformancën gjatë periudhës Tetor - Dhjetor 2022, duke krahasuar atë me realizimin e tre mujorit të katërt të vitit 2021, duke krahasuar realizimin e kësaj periudhe me periudhën e njëjtë të vitit paraprak 2021.

Pasqyra e realizimit të transportit të udhëtarëve:

- Biletat e shitura: 19 055
- Numri i udhëtarëve: 19 055

Më poshtë paraqesim tabelën nr. 4.1 ku kemi krahasimin e të dhënave të realizuara gjatë kësaj periudhe me të dhënat e periudhës së njëjtë të vitit të kaluar:

	Realizimi në Vitin 2021	Realizimi në Vitin 2022	Ndryshimi në %
Numri i udhëtarëve	**16 180**	**19 055**	**17.77%**
Të hyrat nga biletat pa TVSH	**6,304.25 €**	**15,794.39 €**	**150.54%**

Tabela Nr. 4.1

IV.2 Organizimi dhe realizimi i transportit të udhëtarëve

Në tabelën nr. 4.2 janë paraqitur krahasimet e përgjithshme të të dhënave të realizuara në periudhën Tetor – Dhjetor 2022 me periudhën e njëjtë të vitit 2021, rezulton se kemi një rritje të numrit të udhëtarëve në këtë vit.

Përshkrimi - Udhëtarë	Tetor – Dhjetor
Realizimi i numrit të udhëtarëve në 2021	**16,180**
Realizimi i numrit të udhëtarëve në 2022	**19,055**
Planifikimi i numrit të udhëtarëve në 2022	**20,000**
Dallimi: Realizim 2022 - 2021	**2,875**
Dallimi: realizim - planifikimi 2022	**-945**
Dallimi: 2022 - 2021	**17.77**
Dallimi: realizim - planifikimi 2022	**-4.72**

Tabela Nr. 4.2

Siç shihet nga shënimet e paraqitura më lart, sa i përket transportit të udhëtarëve për këtë periudhë kohore kemi pasur një numër të udhëtarëve më të madh krahasuar me vitin e kaluar, me një rritje prej **17.77 %.**

IV.3 Numri i trenave, tren kilometër (T/km) dhe udhëtarë kilometër (U/km)

Numri i trenave të udhëtarëve për tre mujorë gjithsej kanë qenë **552**.
Të gjithë trenat e udhëtarëve për këtë tre mujorë kanë bërë **33,580** tren / km.
Për këtë tre mujorë kanë qenë **1,343,200** udhëtarë/kilometër.

IV.4 Vonesat e trenave të udhëtarëve

Prej 552 trena sa kanë operuar në ketë periudhë raportuese, vetëm 6 trena prej tyre kanë shkaktuar këto vonesa siç shihen më poshtë:

Shkaku i vonesave	Minuta	Në përqindje (%)
Lokomotiva HM	0	0.00
Vazhdimi i udhëtimit	167	42.60
Kryqëzimet	0	0.00
Lokomotiva / GM defekt	0	0.00
Lidhja me trenin	0	0.00
Bashkëngjitja e vagonëve. Tërheqja e mjeteve	0	0.00
Doganë + Polici	0	0.00
Pret në garniturë	0	0.00
Aksidente	0	0.00
Të tjera	225	57.40
Total vonesat	**392**	**100**

Tabela Nr. 4.3

Sfidë kryesore aktualisht në kuadër të DTU, është nevoja urgjente për furnizim me mjete lëvizëse dhe plotësim të vendeve të punës për arritjen e objektivave të punës në sektorin e transportit të udhëtarëve. Kërkesat tona janë adresuar përmes planit të punës për vitin 2022 dhe 2023, po ashtu në vazhdimësi kemi paraqitur nevojat/kërkesat dhe raportët mbi gjëndjen e mjetëve lëvizese.

V. DEPARTAMENTI I TRANSPORTIT TË MALLRAVE

V.1 Pasqyra e performancës operative

Në këtë pjesë të raportit do të paraqesim indikatorët fizikë të performancës sonë operative gjatë periudhës 3 mujore nga 01 Tetor 2022 deri më 31 Dhjetor 2022, duke prezantuar realizimin e detyrave në Departamentin e Transportit të Mallrave, krahasuar me planifikimin që është bërë për të njëjtën periudhë me Planin e rishikuar të Biznesit të vitit 2022 si dhe duke krahasuar realizimin e vitit paraprak 2021 për të njëjtën periudhë raportuese. Natyrisht do të komentojmë ndryshimet që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe.

Departamenti i Transportit të Mallrave gjatë kësaj kohe është munduar që të ketë një koordinim të mirë si brenda departamentit ashtu edhe me Departamentin e Transportit të Udhëtarëve, Administratës, Departamentin e Zhvillimit të Biznesit si dhe Zyrës së Kontrollit, Sigurisë dhe Kualitetit ku nga vërejtjet dhe sugjerimet e tyre kemi bërë ndryshime që kanë qenë të mirëseardhura për kompaninë.

V.2 Rezultatet e arritura nga transporti i mallrave

Në Departamentin e Transportit të Mallrave për periudhën tremujore respektivisht nga 01 Tetor 2022 deri më 31 Dhjetor 2022 kemi pasur këto rezultate:

Përshkrimi – Sasia e Transportuar	Tetor – Dhjetor 2022
Realizimi neto Ton në 2021	17,810.25 Ton
Realizimi Neto Ton në 2022	0.00 Ton
Planifikimi Neto Ton në 2022	156,450.00 Ton
Dallimi: Realizim 2022 – Realizim 2021	-17,810.25 Ton
Dallimi: Realizim – Planifikim në 2022	-156,450.00 Ton
Dallimi: Realizim 2022 – Realizim 2021 (%)	0.00 %
Dallimi: Realizim 2022– Planifikim 2022 (%)	0.00 %

Tabela Nr. 5.1

Siç mund të shihet nga tabela 5.1 në periudhën Tetor – Dhjetor 2022 kemi transportuar 0.00% në dallim përqindje (%) me periudhën e njëjtë raportuese të vitit të kaluar dhe 0.00% në raport me sasinë e planifikuar për transport për periudhën Tetor – Dhjetor 2022.

Transporti i mallrave me kontejnera për këtë periudhë ka qenë:

Përshkrimi – Numri i Transportuar i kontejnerëve	Tetor – Dhjetor 2022
Kontejnerë të plotë – 2022	0 copë
Kontejnerë të zbrazët – 2022	0 copë

Tabela Nr. 5.2

Sasia e transportuar në Neto ton për periudhën Tetor – Dhjetor 2022




Figura Nr . 5.1

Siç mund të shihet nga figura 5.1 në aspektin operativ kemi arritur të realizojmë 0.00% nga planifikimi sipas Planit të rishikuar të Biznesit për periudhën tremujore Tetor – Dhjetor 2022.

Të hyrat nga transporti i mallrave për periudhën raportuese janë:

Përshkrimi	Të hyrat në periudhën tremujore (Tetor – Dhjetor) 2022
Realizim shitje të hyra 2021	58,456.77 €
Realizim shitje të hyra 2022	0.00 €
Planifikimi 2022	461,136.44 €
Realizim 2022 - Realizim 2021	-58,456.77 €
Realizim – Planifikim 2022	-461,136.44 €
Realizim 2022 - Realizim 2021 (%)	0.00 %
Realizim – Planifikim 2022 (%)	0.00 %

Tabela Nr. 5.3

Siç mund të shihet nga tabela 5.3 Neto Ton të shprehura në të hyra me vlerë euro, kemi arritur 0.00 % realizim nga planifikimi, për periudhën Tetor – Dhjetor 2022 sipas Planit të rishikuar të Biznesit.

Të hyrat në periudhën tremujore Tetor – Dhjetor 2022




Figura Nr . 5.2

Të hyrat dhe shpenzimet nga transporti i mallrave:

Përshkrimi	Të hyrat dhe shpenzimet
Shitjet nga transporti i mallrave	0.00 €
Të ardhura tjera nga transporti i mallrave	0.00 €
Total shitjet	0.00 €
Shpenzimet direkte në transportin e mallrave	87,316.19 €
Shpenzimet indirekte në transportin e mallrave	0.00 €
Total shpenzimet	87,316.19 €
Fitimi/humbja operative	-87,316.19 €
Fitimi/humbja në %	0.00 %

Tabela Nr. 5.4

Siç mund të shihet nga tabela 5.4 Transporti i Mallrave ka pasur një humbje prej -87,316.19 euro.

Sqarim: Në vlerën prej 87,316.19 euro, hyjnë Pagat: 86,272.51 euro si dhe Revokimet e trenave vendor të klientit New Co Ferronikeli në vlerë prej 1,043.68 euro.

V.3 Shfrytëzimi i Trenave

Gjatë periudhës tre mujore (Tetor – Dhjetor 2022) kemi këta trena të realizuar.

Tetor – Dhjetor 2022	Trena të planifikuar	Trena të shfrytëzuar	Shfrytëzim/Planifikim në % 2022
Import	39	0	0.00 %
Export	39	0	0.00 %
Vendor	114	0	0.00 %
Total	192	0	0.00 %

Tabela Nr. 5.5

V.4 Efektiviteti i Trenave

Efektiviteti i Trenave për periudhën Tetor – Dhjetor 2022 është pasqyruar në tabelën si më poshtë.

	Pesha max.bartese t/tren	Mesatarja e çdo treni - bt	Efektiviteti (%)
Import	1200 bt	0.00 bt	0.00 %
Eksport	1200 bt	0.00 bt	0.00 %
Vendor	1400 bt	0.00 bt	0.00 %

Tabela Nr. 5.6

V.5 Neto Ton & Neto Ton Kilometër të transportuar

Neto ton	Realizim Tetor – Dhjetor 2022	Planifikim Tetor – Dhjetor 2022	Realizim/Planifikim 2022 në %	Neto ton kilometër	Humbje Planifikim/Realizim 2022 (ton)
Import	0.00	97,950.00	0.00 %	0	-97,950.00 t
Export	0.00	24,530.00	0.00 %	0	-24,530.00 t
Vendor	0.00	33,971.00	0.00 %	0	-33,971.00 t
Total	0.00	156,450.00	0.00 %	0	-156,450.00 t

Tabela Nr. 5.7

V.6 Mallrat e transportuara

Gjatë Tetor – Dhjetor 2022 nuk ka pasur mallra të transportuara për shkak të mbylljes 24 orëshe të linjës hekurudhore Miradi – Hani i Elezit, si dhe për shkak të ndërprerjes së transportit vendor nga klienti NewCo Ferronikeli.

V.7 Revokimi i trenave

Më poshtë do ti paraqesim revokimet e trenave të mallrave të ndarë sipas kategorive Import, Eksport dhe Vendorë.

Tetor – Dhjetor 2022	Trena të revokuar me 0%	Trena të revokuar me 10%	Trena të revokuar me 20%	Trena të revokuar me 100%	Vlera në euro e revokimeve
Import - Export	78	0	0	0	0.00 €
Vendor	0	218	10	0	1,043.68 €
Total	78	218	10	0	1,043.68 €

Tabela 5.8

Nga tabela 5.8 shihet se gjatë periudhës Tetor – Dhjetor 2022 në Import dhe Eksport janë revokuar në total shtatëdhjetë e tetë (78) trena. Të gjithë trenat e revokuar janë revokuar me 0% për shkak të mbylljes 24 orëshe të segmentit hekurudhor Miradi – Hani i Elezit për të punuar. Duhet theksuar se Menaxheri i Infrastrukturës për këto revokime nuk na ngarkon me shpenzime të revokimit.

Po ashtu nga tabela 5.8 shihet se gjatë periudhës Tetor – Dhjetor 2022 në transport Vendor janë revokuar në total dyqind e njëzet e tetë (228) trena. Dyqind e tetëmbëdhjetë (218) trena janë revokuar me 10% (njëqind e nëntë (109) të plotë dhe njëqind e nëntë (109) të zbrazët), dhe dhjetë (10) trena janë revokuar me 20% (pesë (5) të plotë dhe pesë (5) të zbrazët). Revokimi i këtyre trenave ka ndodhur për arsye se klienti New Co Ferronikeli ka ndërprerë transportin nga muaji Tetor 2021.

VI. ZYRA E MIRËMBAJTJES SË MJETEVE LËVIZËSE – MML

VI.1 Pasqyra e performancës operative

Në këtë pjesë të raportit do të paraqesim performancën gjatë periudhës 01 Tetor 2022 deri më 31 Dhjetor 2022, duke krahasuar me realizimin e tre mujorin të katërt (TM4) të viti 2021.

VI.2 Sektori i mirëmbajtjes

Në Zyrën e Mirëmbajtjes së Mjeteve Lëvizëse përfshihen:

Mirëmbajtja e trenave motorik, mirëmbajtja e lokomotivave transportuese, mirëmbajtja e lokomotivave manovruese, mirëmbajtja e vagonëve për transportin e udhëtareve, mirëmbajtja e vagonëve për transportin e mallrave dhe punë të tjera për riparimin e vagonëve të huaj.

VI.2.1 Mirëmbajtja e trenave motorik

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e trenave motorik të realizuara ne periudhën Tetor – Dhjetor 2022 krahasuar me periudhën Tetor – Dhjetor 2021.

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	Tetor - Dhjetor 2022	Tetor - Dhjetor 2021	Ndryshimi
1.	Servisime	0	0	0
2.	Riparime	0	0	0
3.	Kontrollime K1	0	0	0
4.	Kontrollime K3	0	0	0
5.	Kontrollime K6	0	0	0
6.	Gdhendje të rrotave	0	0	0

Tabela 6.1

VI.2.2 Mirëmbajtja e Lokomotivave Transportuese

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e lokomotivave transportuese të realizuara në periudhën Tetor – Dhjetor 2022, krahasuar me periudhën Tetor – Dhjetor 2021.

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	Tetor - Dhjetor 2022	Tetor - Dhjetor 2021	Ndryshimi
1.	Servisime	66	78	-12
2.	Riparime	13	4	8
3.	Kontrollime K1	2	8	-6
4.	Kontrollime K3	1	3	-2
5.	Kontrollime K6	1	1	0
6.	Gdhendja e rrotave	0	1	-1

Tabela 6.2

VI.2.3 Mirëmbajtja e Lokomotivave Manovruese

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e lokomotivave manovruese të realizuara në periudhën Tetor - Dhjetor 2022 krahasuar me periudhën Tetor - Dhjetor 2021.

	Lloji i Riparimit/Mirëmbajtjes	Tetor - Dhjetor 2022	Tetor - Dhjetor 2021	Ndryshimi
1.	Servisime	0	2	-2
2.	Riparime	2	1	1
3.	Kontrollime K1	2	3	-1
4.	Kontrollime K3	1	0	1
5.	Kontrollime K6	0	0	0

Tabela 6.3

VI.2.4 Intervenimet në mjetet tërheqëse

Intervenimet në mjetet tërheqëse gjatë periudhës tre mujore për secilin mjet tërheqës është dhënë në tabelën në vazhdim:

Mjetet tërheqëse (Nr.)	2620 005	2640 007	2640 008	2710 009	2640 010	2620 0016	2760 001	2760 002	5800 004
Servisime (S)	0	7	4	0	0	49	0	0	0
Riparime (R)	1	1	1	3	0	3	1	0	0
Kontrollime (K 1)	0	0	0	0	0	3	2	0	0
Kontrollime (K 3)	0	0	0	0	0	1	1	0	0
Kontrollime (K 6)	0	1	0	0	0	0	0	0	0
Gdhendje të rrotave	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Tabela 6.4

Servisime – S
Riparime - R
Kontrollime njëmujor – K1
Kontrollime tremujor – K3
Kontrollime gjashtëmujor – K6

VI.2.5 Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e udhëtareve

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e testimeve të komponentëve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e vagonëve të udhëtareve realizuar në periudhën Tetor - Dhjetor 2022, krahasuar me periudhën Tetor - Dhjetor 2021.

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	Tetor - Dhjetor 2022	Tetor - Dhjetor 2021	Ndryshimi
1.	Kontrollime (K1)	17	22	-5
2.	Riparim në punëtori	15	23	-7
3.	Kontrollime në stacion	0	0	0
4.	Gdhendje të rrotave	10	6	4
5.	Testim i komponentëve	0	0	0

Tabela 6.5

IV.2.6 Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e mallrave

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e testimeve të komponentëve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e vagonëve të mallrave të realizuar në periudhën Tetor - Dhjetor 2022, krahasuar me periudhën Tetor – Dhjetor 2021.

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	Tetor - Dhjetor 2022	Tetor - Dhjetor 2021	Ndryshimi
1.	Kontrollime K3	0	3	-3
2.	Riparim në punëtori	0	1	-1
3.	Riparim në tren	0	0	0
4.	Gdhendje të rrotave	0	1	-1

Tabela 6.6

VI.2.7 Riparimi i vagonëve të huaj

Gjatë këtij tre mujori, Zyra e Mirëmbajtjes së Mjeteve Lëvizëse, në vagonët e New Co Ferronikeli është kryer kontrollimi K3 sipas kontratës si dhe janë kryer riparimet tjera që nuk janë në kontratë e që ka qenë e nevojshme të kryhet.

Në tabelën nr.6.7, janë paraqitur vlerat e punëve të kryera për periodën Tetor - Dhjetor 2022 dhe është krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Riparimi/mirëmbajtja e vagonëve të huaj	Tetor - Dhjetor 2022	Tetor - Dhjetor 2021
New Co Ferronikeli	**00.00 €**	**1,484.50 €**

Tabela 6.7

VII. DEPARTAMENTI I PROKURIMIT

VII.1 Projektet kapitale për periudhën Tetor – Dhjetor 2022

Në tabelën 7.1, janë paraqitur projektet të cilat janë zhvilluar gjatë periudhës Tetor - Dhjetor 2022.

	Titulli i aktivitetit të prokurimit	Data e nënshkrimit të kontratës	Vlera e parashikuar	Çmimi i kontratës	Koment
1.	Furnizimi me thika për torno për gdhendjen e rrotave	Nëntor	800.00	800.00	Përfunduar
2.	Furnizimi dhe instalimi i pompës, softuerit dhe pjesëve ndërlidhëse për shpërndarjen e naftës	Nëntor	19,000.00	19,000.00	Përfunduar
3.	Shërbimet e atestimit të vinçit 10t	Nëntor	2,500.00	2,449.00	Përfunduar
4.	Furnizimi dhe montimi i perdeve në sallën e takimeve	Nëntor	400.00	392.58	Përfunduar
5.	Shërbimet e shtypjes së Orarit të Lëvizjes së trenave	Nëntor	800.00	740.00	Përfunduar
6.	Furnizimi me material higjiene për nevojat e Trainkos Sh. A.	Nëntor	5,900.00	5,831.56	Përfunduar
7.	Shërbimet e matjes së kënaqshmërisë së klientëve	Nëntor	976.00	652.54	Përfunduar
8.	Furnizimi dhe instalimi i pompave termike	Nëntor	120,114.80	114,151.40	Përfunduar
9.	Furnizimi, instalimi dhe mirëmbajtja e sistemit për menaxhimin e hyrje daljeve	Nëntor	7,500.00	4,900.00	Përfunduar
10.	Furnizimi dhe montimi i derës në MML	Dhjetor	1,900.00	1,790.00	Përfunduar
11.	Furnizim me material ndërtimor për pushimoren në Pejë	Dhjetor	600.00	597.02	Përfunduar
12.	Furnizimi me materiale reklamuese për fund vit	Dhjetor	4,500.00	2,790.00	Përfunduar

Tabela 7.1

VIII. ZYRA LIGJORE

Gjatë periudhës kohore tetor – dhjetor 2022, nga zyra ligjore e ndërmarrjes janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme për përfaqësim sa më të mirë në çështjet ligjore pranë të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës. Gjatë periudhës kohore tetor - dhjetor 2022, pranë Gjykatave Themelore kanë qenë të caktuara 8 seanca gjyqësore për proceset në të cilat kemi qenë palë në procedurë qoftë në cilësinë e të paditurës apo të paditëses.

Gjatë periudhës kohore tetor - dhjetor 2022, ndërmarrja në procedurë gjyqësore është përballur dhe ka zhvilluar veprime procedurale në tri (**3**) konteste për kompensim dëmi, një (**1**) kontest pune, dhjetë (**10**) lëndë përmbarimore ku dy (**2**) lëndë kanë përfunduar me vendim të përmbaruesit. Një (**1**) lëndë me aktvendim nga Gjykata Themelore në Prishtinë, një (**1**) Propozim për përmbarim, një (**1**) lëndë është nxjerr aktgjykim nga Gjykata Themelore dhe procedura ka vazhduar në Gjykatën e Apelit

VIII.1. Kontestet për Kompensim Dëmi

Nga kontestet e kompensimit të dëmeve gjatë periudhës tetor – dhjetor 2022, ka pasur në procedurë gjyqësore tri (3) konteste:

Nr.	Nr. Lëndës	Vlera euro (€)	Cilësia e HK – Trainkos SH. A. Si palë në procedurë
1.	C.nr.172/22	100,000.00 €	E paditur nga Hamide Krasniqi etj.
2.	C.nr.302/16		E paditur nga Pashk Coli
3.	C.nr.53/16	2,000.00 €	E paditur nga Ideal Foniqi

Tabela 8.1

1.Me datë 04.10.2022 kemi marr pjesë në seancën gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Dega në Gllogoc në lëndën kompensim dëmi C.nr.172/22, paditës **Hamide Krasniqi** etj., e paditur Hekurudhat e Kosovës "Trainkos" Sh. A., Komuna e Gllogocit dhe KS "Sigma", ku janë ftuar në mënyrë të rregullt por përfaqësuesi i Komunës dhe i KS "Sigma" nuk kanë qenë prezent dhe seanca është shtyrë me datë 08.11.2022 në orën 13:30.

Me datë 08.11.2022 kemi marr pjesë në seancën e mbajtur në Gjykatën Themelore në Gllogoc në lëndën kompensim dëmi C.nr.172/22, paditësit: **Hamide Krasniqi** etj., të paditur: 1. Hekurudhat e Kosovës "Trainkos" Sh. A., 2. Komuna e Gllogocit, dhe 3. KS "Sigma" ku ne si palë e paditur mbetemi në tërësi pranë përgjigjes në padi pran të gjitha thënieve dhe kundërshtimeve të seancave paraprake dhe gjithashtu konstatojmë se e kemi pranuar ekspertizën e punuar nga eksperti dhe ndaj të njëjtës nuk kemi vërejtje, me këtë ekspertizë ne konstatojmë në këtë çështje juridiko-kontestimore ne nuk kemi legjitimitet që të jemi pale në procedure, andaj edhe e kontestojmë në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë. Pastaj gjykata merr Aktvendim që seanca e sotme përgatitore ka përfunduar, ndërsa seanca e ardhshme kryesore në këtë çështje caktohet për datën 09.12.2022 në ora 13:30.

Me datë 30.11.2022 nga Av. **Gafurr Elshani** dhe **Sahit Bibaj** përfaqësues të paditëses **Hamide Krasniqi** etj., kemi pranuar Parashtresë për precizim të serishëm të lartësisë së kërkesë padisë dhe tërheqje të padisë ndaj të paditurës së dytë dhe tretë. Lënda kompensim dëmi C.nr.172/2022, vlera e kontestit: 96,191.80 Euro, e paditur 1.Komuna e Gllogocit - Drenasit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, ndërsa tërheqje të padisë ndaj 2. KS "Sigma" në Prishtinë dhe 3. Hekurudhat e Kosovës "Trainkos" Sh. A.

Me datë 09.12.2022 kemi marr pjesë në seancë në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Dega në Gllogoc, lënda: kompensim dëmi, vlera e kontestit 96,191.08€ Paditës: **Hamide Krasniqi** etj, Të padituratː 1. Komuna e Gllogocit, 2. KS " Sigma", 3. Hekurudhat e Kosovës "Trainkos" Sh. A., por në mungesë të paditurës së parë Komuna e Gllogocit ka kërkuar ndërprerjen e procedurës në afat prej 3 muaj në mungesë të përfaqësuesit ligjor. Gjykata merr Aktvendim që seanca të shtyhet.

Me datë 14.12.2022 kemi pranuar Aktvendim nga Gjykata Themelore në Prishtinë - Dega në Gllogoc, lënda kompensim dëmi C.nr.172/22, vlera e kontestit 96,191.08 €, paditësit: **Hamide Krasniqi** etj, të paditura: 1. Komuna e Gllogocit, 2. KS "Sigma", 3. Hekurudhat e Kosovës "Trainkos" Sh. A. ku Gjykata në këtë Aktvendim vendos që e paditura e pare Komuna e Gllogocit në afatin e kërkuar prej tre muajve për të krijuar kushte ligjore në shqyrtimin kryesor të deklarohet lidhur me precizimin e kërkesëpadisë së paditësve dhe tërheqjen e padisë së paditësve kundër dy të padituravetjera dhe provave të administruara si dhe të paraqesë fjalën përfundimtare dhe deklarimet e dy të padituravetKS "Sigma" dhe Hekurudhat e Kosovës "Trainkos" Sh. A. se nuk e kanë kontestuar tërheqjen e padisë së paditësve ndaj këtyre dy të padituravetpërkatësisht kanë kërkuar shpenzimet e procedurës.

2. Me datë 05.10.2022 nga Gjykata Themelore në Klinë kemi pranuar thirrje për shqyrtimin kryesor lënda kompensim dëmi C.nr.302/16, paditës **Pashk Coli** etj., e paditur Hekurudhat e Kosovës "Trainkos" Sh. A. me datë 18.10.2022 ora 9:30.

Me datë 17.10.2022 është përgatit parashtresë për kundërshtimin e ekspertizës së punuar nga **Fitim Shala**, Gjykatës Themelore në Pejë - dega në Klinë, lënda kompensim dëmi C.nr.302/16, paditësit **Pashk Coli** etj, e paditur Hekurudhat e Kosovës "Trainkos" Sh. A., ku është kërkuar për ekspert të caktohet grupi i ekspertëve nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Teknik.

Me datë 18.10.2022 kemi marr pjesë në seancë gjyqësore në Gjykatën Themelore në Pejë - dega në Klinë në lëndën kompensim dëmi C.nr.302/16, paditës **Pashk Coli** etj., e paditur Hekurudhat e Kosovës "Trainkos" Sh. A. ku përfaqësuesi i të paditurës i propozon gjykatës që të caktoj një ekspertizë tjetër nga grup ekspertësh nga Fakulteti Teknik me kusht që të jenë ekspert të komunikacionit hekurudhor. Gjykata merr aktvendim që të aprovohet propozimi i të autorizuarit të paditurës për caktimin e një ekspertize nga grup ekspertësh nga Fakulteti Teknik - Departamenti i Hekurudhave të cilët do të përpilojnë ekspertizën nga ekspertët adekuat që do ti caktoj ky departament.

3. Me datë 10.10.2022 kemi marr pjesë në seancën gjyqësore në Gjykatën Themelore në Pejë - dega Klinë në lëndën kompensim dëmi C.nr.53/16, vlera e kontestit 2,000.00 Euro, paditës **Ideal Foniqi**, e paditur Hekurudhat e Kosovës "Trainkos" Sh. A, dhe "Infrakos" Sh. A. ku janë ftuar në

mënyrë të rregullt por përfaqësuesi i të padituërës së dytë "Infrakos" Sh. A. nuk ka qenë prezent dhe seanca është shtyrë me datë 09.11.2022 në orën 10:00. Ku gjatë pjesëmarrjes kemi pranuar nga pala paditëse padinë e paditësit bashkangjitur me shkresat tjera.

Me datë 10.10.2022 kemi marr pjesë në seancën gjyqësore në Gjykatën Themelore në Pejë - dega Klinë në lëndën kompensim dëmi C.nr.53/16, vlera e kontestit 2,000.00 Euro, paditës **Ideal Foniqi**, e paditur Hekurudhat e Kosovës "Trainkos" Sh. A., dhe "Infrakos" Sh. A. ku janë ftuar në mënyrë të rregullt por përfaqësuesi i të padituërës së dytë "Infrakos" Sh. A. nuk ka qenë prezent dhe seanca është shtyrë me datë 09.11.2022 në orën 10:00. Ku gjatë pjesëmarrjes kemi pranuar nga pala paditëse padinë e paditësit bashkangjitur me shkresat tjera.

Aktgjykimet dhe Aktvendimet

Aktgjykimet, Aktvendimet dhe Revizionet e pranuara nga Gjykatat e Kosovës do t'i paraqesim në tabelën si vijon:

Nr.	Nr. Lëndës	Vlera euro (€)	Cilësia e HK – Trainkos SH.A. si palë në procedurë	Veprimet e ndërmarra në procedurë
1.	Ac.nr.1553/2018	100,000.00 €	E paditur nga Hamide Krasniqi	Aktvendimi i Gjykatës Themelore i dt.14.12.2022, për ndërprerje 3 muaj të procedurës.

Tabela 8.2

Me datë 14.12.2022 kemi pranuar Aktvendim nga Gjykata Themelore në Prishtinë - Dega në Gllogoc, lënda kompensim dëmi C.nr.172/22, vlera e kontestit 96,191.08 €, paditësit: **Hamide Krasniqi** etj., të paditura: 1. Komuna e Gllogocit, 2. KS "Sigma", 3. Hekurudhat e Kosovës "Trainkos" Sh. A. ku Gjykata në këtë Aktvendim vendos që e paditura e pare Komuna e Gllogocit në afatin e kërkuar prej tre muajve për të krijuar kushte ligjore në shqyrtimin kryesor të deklarohet lidhur me precizimin e kërkesëpadisë së paditësve dhe tërheqjen e padisë së paditësve kundër dy të padituarave tjera dhe provave te administruara si dhe të paraqesë fjalën përfundimtare, dhe deklarimet e dy të padituarave KS "Sigma" dhe Hekurudhat e Kosovës "Trainkos" Sh. A. se nuk e kanë kontestuar tërheqjen e padisë së paditësve ndaj këtyre dy të padituarave përkatësisht kanë kërkuar shpenzimet e procedurës.

VIII.2. Kontestet nga Mardhanja e Punës

Nga kontestet e punës gjatë periudhës tetor – dhjetor 2022, ka pasur në procedurë gjyqësore 1 kontest:

Nr.	Nr. i lëndës	Vlera euro (€)	Cilësia e HK - Trainkos SH.A. si palë në procedurë
1.	C.nr.702/18	4,874.00 €	E paditur nga Sabit Berisha

Tabela 8.3

1.Me datë 13.10.2022 kemi marr pjesë në seancën gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë në lëndën kontest pune C.nr.702/18, paditës **Sabit Berisha**, e paditur Hekurudhat e Kosovës Trainkos Sh. A., me fillimin e seancës kemi pranuar Parashtresë për precizimin e kërkesëpadisë nga paditësi **Sabit Berisha** të cilin e përfaqëson **Av. Selim Nikqi** nga Prishtina ku e mbështesin ekspertin financiar, ndërsa përfaqësuesi i autorizuar i të padituërs e kundërshton ekspertizën dhe mbetet në tërësi pran përgjigjes në padi si dhe deklarimeve gjatë seancave të kaluara, dhe gjykata merr Aktvendim që të kthehet në plotësim ekspertiza e ekspertit **Aziz Berisha** e datës 10.03.2022 dhe obligohet eksperti financiar që mendimin dhe konstatimin, respektivisht ekspertizën financiare t'ia dorëzoj me shkrim në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët ndërgjygjëse ndërsa vazhdimi seancës së shqyrtimit kryesor caktohet me datë 03.11.2022 në ora 9:00.

Me datë 01.11.2022 kemi punuar në ekspertizën e punuar nga eksperti, **prof. Aziz Berisha** në lëndën C.nr.702/18, paditësi **Sabit Berisha** e paditur Hekurudhat e Kosovës Trainkos Sh. A. ku e kundërshtojmë ekspertizën për shkak të bazës juridike të kërkesëpadisë dhe mbesim edhe më tej pran mendimeve dhe kundërshtimeve tona duke marr parasysh që shkarkimi i paditësit është bërë në përputhje me rregulloren e brendshme të punës dhe procedurës disiplinore.

Me datë 03.11.2022 kemi marr pjesë në seancën e mbajtur në Gjykatën Themelore në Prishtinë në lëndën kontest pune C.nr.702/18, vlera 5,784 € paditës **Sabit Berisha**, e paditur Hekurudhat e Kosovës "Trainkos" Sh. A. ku fjala përfundimtare e palëve është se palët mbesin edhe më tej pran mendimeve, kundërshtimeve të tyre. Ndaj gjykata konstaton se procedura gjyqësore lidhur me këtë çështje juridiko kontestimore përfundoi.

Me datë 01.12.2022 kemi pranuar Aktgjykim nga Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti I Përgjithshëm – Divizioni Civil, në lëndën kontest pune C.nr.702/18, datë 03.11.2022 vlera e kontestit 4,874.00 €, paditësi **Sabit Berisha**, e paditur: Hekurudhat e Kosovës "Trainkos" Sh. A., ku sipas këtij Aktgjykimi Gjykata Themelore në Prishtinë vendos në favor të paditësit.

Me datë 07.12.2022 është ushtruar Ankesë në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil për Gjykatën e Apelit në Prishtinë, lënda kontest pune C.nr.702/18, paditësi: **Sabit Berisha**, e paditur: Hekurudhat e Kosovës Trainkos Sh. A.

Aktgjykimet dhe Aktvendimet

Aktgjykimet, Aktvendimet dhe Revizionet e pranuara nga Gjykatat e Kosovës do t'i paraqesim në tabelën si vijon:

Nr.	Nr. lëndës	Vlera euro (€)	Cilësia e HK – Trainkos SH.A si palë në procedurë	Veprimet e ndërmarra në procedurë
1.	C.nr.702/18	5,784.00 €	E paditur, paditës Sabit Berisha	Aktgjykimi i Gjykatës Themelore, në favor të paditësit, Ankesë në Gjykatën e Apelit C.nr.702/18. Lënda në procedurë.

Tabela 8.4

Me datë 01.12.2022 kemi pranuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil në çështjen juridike kontestimore, lënda C.nr.702/18, vlera 4,874.00 Euro, të paditësit **Sabit Berisha** nga fshati Miradi e Poshtme Komuna e Fushë Kosovës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson **Av. Selim Nikqi** nga Prishtina, kundër të padituresë HK "Trainkos" Sh. A. me seli në Fushë Kosovë, ku Aprovohet e bazuar kërkesë padia e paditësit **Sabit Berisha** dhe Anulohen si të paligjshme vendimet e të padituresë HK " Trainkos" Sh. A.

Me datë 07.12.2022 është ushtruar Ankesë në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil për Gjykatën e Apelit në Prishtinë, lënda kontest pune C.nr.702/18, paditësi: **Sabit Berisha**, e paditur: Hekurudhat e Kosovës "Trainkos" Sh. A., kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil C.nr.702/18, datë 03.11.2022, për shkak të: a) shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimiore, b) konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, c) Zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, kemi propozuar Aktvendim që të **APROVOHET** e bazuar Ankesa e padituresë ''Trainkos'' Sh. A., ashtu që aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.702/18 datë 03.11.2022 të PRISHET dhe ta hedhë poshtë padinë ose çështja të kthehet në rigjykim në Gjykatën e shkallës së parë.

VIII.3 Kontestet nga Konflikti Administrativ

Nga kontestet në konflikt administrativ gjatë periudhës tetor – dhjetor, nuk ka pasur në procedurë asnjë kontest dhe nuk kemi pranuar asnjë shkresë për kontestet që janë në gjykatë.

Nr.	Nr. i lëndës	Vlera euro (€)	Cilësia e HK – Trainkos SH.A. si palë në procedurë
1.			

Tabela 8.5

VIII.4. Kontestet për Pagim Borgji

Nga kontestet për pagim borxhi gjatë periudhës tetor – dhjetor, nuk ka pasur në procedurë gjyqësore asnjë kontest dhe nuk kemi pranuar asnjë shkresë për kontestet që janë në gjykatë.

Nr.	Nr. i lëndës	Vlera euro (€)	Cilësia e HK – Trainkos SH.A. si palë në procedurë
1.			

Tabela 8.6

Aktgjykimet dhe Aktvendimet

Aktgjykimet, Aktvendimet dhe Revizionet lidhur me kontestet për pagim borxhi nuk kemi pranuar nga Gjykatat e Kosovës.

Nr.	Nr. i lëndës	Vlera e shpenzimeve në euro (€)	Cilësia e HK – Trainkos SH.A. si palë në procedurë	Veprimet e ndërmarra në procedurë
1				

Tabela 8.7

VIII.5. Lëndët në Procedurë Përmbarimore

Nga kontestet në procedurë përmbarimore gjatë periudhës tetor – dhjetor 2022, ka pasur në procedurë gjyqësore 10 konteste:

Nr.	Nr. i lëndës	Vlera e shpenzimeve në euro (€)	Cilësia e HK – Trainkos SH.A si palë në procedurë	Veprimet e ndërmarra në procedurë
1.	P.nr.496/2019		Debitor, kreditor, "Bar Restorant Orhide"	Gjykata Themelore në Prishtinë me dt.20.02.2020 ka marrë vendim në favor të ndërmarrjes, kreditori nuk ka ushtruar ankesë, lënda është përfunduar.
2.	P.nr.132/2017		Debitor, kreditor "Kosova Thëngjilli" Sh. A.	Gjykata Themelore në Prishtinë me dt.26.06.2018 pas anulimit të urdhrit, përmbaruesi nxjerr konkluzion dhe përfundohet lënda P.nr.132/2017 me dt.01.12.2022 .
3.	P.nr.422/19	1,850.00 Euro	Debitor, kreditor Herta Sh.P.K.	Gjykata Themelore në Prishtinë në favor të ndërmarrjes, nuk kemi ankesë nga Kreditori.
4.	E.nr.585/13		Debitor, Kreditor, "Europrinty" Sh.P.K.	Kemi dërguar Urgjencë në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, ku deri më tani nuk kemi pranuar asgjë.
5.	P.nr.282/6		Kreditor, debitor Hasan Simnica	Kemi parashtruar kërkesë pranë Përmbaruesit Privat. Ende nuk kemi marrë përgjigje.
6.	P.nr.454/19		Kreditor, debitor, "Beta" Sh.P.K	Kemi parashtruar kërkesë pranë Përmbaruesit Privat. Ende nuk kemi marrë përgjigje
7.	P.nr.638/21	154,812.76 Euro	Kreditor, Debitor, N.T.SH "Ballkan Shped"	Kemi parashtruar kërkesë pranë Përmbaruesit Privat. Ende nuk kemi marrë përgjigje.
8.	P.nr.359/17	500.00 Euro	Kreditor, debitor, Gjergj Gjoka	Kemi parashtruar kërkesë pranë Përmbaruesit Privat. Ende nuk kemi marrë përgjigje.
9.	P.nr.123/21		Kreditor, Debitor, N.T. "Herolindi"	Aktvendim për transferimin e lëndës..
10.	E.nr.CPC-419/22		Debitor, kreditor, Iljaz Shala	Është ushtruar prapsim..

Tabela 8.8

1. Me datë 27.10.2022 kemi kontaktuar përmes telefonit me përmbaruesen **Emine Sherifi Lubeniqi**, lënda përmbarimore P.nr.496/2019 Kreditor: Bar Restorant Orhide, Debitor: Hekurudhat e Kosovës "Trainkos" Sh. A., Gjykata Themelore në Prishtinë me datë 20.02.2020 ka

marrë vendim në favor të ndërmarrjes, kreditori nuk ka ushtruar ankesë lënda është përfundua dhe vihet në a/a.

2. Me datë 27.10.2022 nga përmbaruesi privat **Fadil Hoxha** lënda përmbarimore P.nr.132/2017, Kreditor: "Kosova Thëngjilli" Sh. A., Debitor: Hekurudhat e Kosovës "Trainkos" Sh. A. kemi pranuar përmes viberit ku pas anulimit të urdhrit nga Gjykata Themelore në Prishtinë me datë 26.06.2018, përmbaruesi nxjerr këtë Konkluzion: Përfundohet në tërësi procedura në këtë çështje nga përmbaruesi, dhe lënda P.nr.132/2017 me datë 01.12.2020 është përfunduar dhe vihet në a/a.

3. Me datë 28.10.2022 kemi kontaktuar përmes telefonit me përmbaruesin privat **Sefer Arifi**, lënda përmbarimore P.nr.422/19, Kreditor: "Herta" Sh.P.K, debitor Hekurudhat e Kosovës "Trainkos" Sh. A, ku mbetet me na njoftuar se deri ku ka arritur lënda se pas aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë ku gjykata vendos në favor të ndërmarrjes, ku ne nuk kemi pas më ankesë nga kreditori.

4. Me datë 24.11.2022 kemi punuar shkresë në lëndën përmbarimore E.nr.585/13 kreditori: "Europrinty" Sh. P. K, debitor Hekurudhat e Kosovës "Trainkos" Sh. A. ku kemi kërkuar Urgjencë nga Gjykata Komerciale në Prishtinë - Departamenti për çështje Ekonomike për procedurat e përfundimit të lëndës se deri më tani nuk kemi pranuar konkluzion lidhur me këtë lëndë. Me datë 07.12.2022 është dërguar Urgjencë për procedurat e përfundimit të lëndës në Gjykatën Komerciale në Prishtinë - Departamenti për çështje Ekonomike, lënda përmbarimore E.nr.585/13, kreditor: ''Europrinty" Sh.P.K, Debitor: Hekurudhat e Kosovës "Trainkos" Sh. A. ku nga ana e debitorit borxhi është kryer në tërësi. Deri më tani nga Gjykata nuk kemi pranuar Aktvendim lidhur me kundërshtimin e ushtruar nga debitori, andaj kemi kërkuar nga Gjykata të veproj me Urgjencë lidhur me procedurat e përfundimit të lëndës.

5. Me datë 14.12.2022 kemi parashtruar kërkesë pranë përmbaruesit Privat **Destan Bujupaj** lidhur me lëndën P.nr.282/6 kundër debitorit **Hasan Simnica** kreditori Hekurudhat e Kosovës "Trainkos" Sh. A. dhe kemi kërkuar të na njoftoj se cilat veprime ka ndërmarrë përmbaruesi për realizimin e borxhit. Ende nuk kemi marr përgjigje.

6. Me datë 14.12.2022 kemi parashtruar kërkesë pranë përmbaruesit Privat **Destan Bujupaj** lidhur me lëndën P.nr.454/19, kreditor Hekurudhat e Kosovës "Trainkos" Sh. A., debitor "Beta" Sh.P.K. dhe kemi kërkuar të na njoftoj se cilat veprime ka ndërmarrë përmbaruesi për realizimin e borxhit. Ende nuk kemi marr përgjigje.

7.Me datë 14.12.2022 kemi kontaktuar përmes telefonit me përmbaruesin privat **Destan Bujupaj** në lëndën përmbarimore N.T.SH. Ballkan Shped P.nr.638/21, shuma 154,812.76 €, kreditor Hekurudhat e Kosovës "Trainkos" Sh. A. Debitor N.T.SH. Ballkan Shped ku kemi kërkuar informacion nga përmbaruesi se deri ku ka arritur lënda, i njëjti na ka informuar se lidhur me kërkesën e kreditorit për verifikim se a ka pasur proces të trashëgimisë nga debitori tek pasardhësit do të parashtroj kërkesat e nevojshme pranë institucioneve përkatëse. Në rast se nuk na njofton në një afat të arsyeshëm ne do të parashtrojmë kërkesë përsëri për veprimet ligjore që ka ndërmarrë përmbaruesi.

8. Me datë 15.12.2022 kemi kontaktuar përmes telefonit por edhe dërguar emal te përmbaruesi privat Ilir Mullhaxha në lëndën përmbarimore **Gjergj Gjoka** P.nr.359/17, shuma 500 € kreditor: Hekurudhat e Kosovës "Trainkos" Sh. A. debitor **Gjergj Gjoka**, ku kemi kërkuar informacion nga përmbaruesi se cilat veprime i ka marre për realizimin e borxhit. Ende nuk kemi marr përgjigje.

9. Me datë 16.11.2022 kemi pranuar nga HK "Infrakos" Sh. A., Parashtresë lidhur me njoftimin e Gjykatës për transferimin e lëndës në kompaninë HK "Trainkos" Sh. A., lënda përmbarimore KPPP.nr.2143/22, bashkangjitur me njoftimin kemi pranuar nga Gjykata Komerciale - dhomat e shkallës së parë, Departamenti për çështje Ekonomike, Aktvendim, Kreditor HK "Infrakos" Sh. A, debitor: N.T. "Herolindi", por me transferimin e lëndës Kreditor është Hekurudhat e Kosovës "Trainkos" Sh. A. dhe ku Gjykata Komerciale me arsyetimin se nuk është kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur sipas propozimit për ekzekutim lidhur me këtë çështje lënda së bashku me shkresat e saj i dërgohet Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamentit të Përgjithshëm.

Me datë 20.12.2022 kemi pranuar nga Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për çështje Ekonomike Aktvendim, në lëndën përmbarimore Kreditor: Hekurudhat e Kosovës "Trainkos" Sh. A., Debitor: N.T. "Herolindi". Gjykata Komerciale jep arsyetimin që kjo Gjykatë nuk është kompetente në pikëpamje lëndore sipas propozimit për ekzekutim, kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje është Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në Prishtinë.

10. Me datë 17.11.2022 është parashtruar Prapësim Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, lënda përmbarimore E.nr.CPC-419/22, kreditor Iljaz Shala të cilin e përfaqëson Av. Zef Berisha nga Prishtina, debitor Hekurudhat e Kosovës "Trainkos" Sh. A.

Aktgjykimet dhe Aktvendimet

Aktgjykimet, Aktvendimet dhe Revizionet e pranuara nga Gjykatat e Kosovës do t'i paraqesim në tabelën si vijon:

Nr.	Nr. i lëndës	Vlera e shpenzimeve në euro (€)	Cilësia e HK – Trainkos SH. A. si palë në procedurë	Veprimet e ndërmarra në procedurë
1.	P.nr.123/21		Kreditor, Debitor, N.T. " Herolindi"	Aktvendim për transferimin e lëndës.

Tabela 8.9

Me datë 20.12.2022 kemi pranuar nga Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike Aktvendim, në lëndën përmbarimore kreditor Hekurudhat e Kosovës " Trainkos" Sh. A., debitor N.T. "Herolindi". Gjykata Komerciale jep arsyetimin që kjo Gjykatë nuk është kompetente në pikëpamje lëndore sipas propozimit për ekzekutim, kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje është Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në Prishtinë.

IX. DEPARTAMENTI I ZHVILLIMIT TË BIZNESIT

IX.1 Planifikimi dhe Zhvillimi i Biznesit

Periudha e kvartalit të katërt (TM4), Tetor – Dhjetorë për DZhB-në konsiderohet si periudhë e bujshme në përgatitjen dhe dorëzimin e dokumenteve strategjike të kompanisë, e që kanë të bëjnë me analizën e periudhës së kaluar dhe planifikimet për periudhën vijuese.

Për këtë i tërë Departamenti i Zhvillimit të Biznesit ka qenë i angazhuar në analizimin dhe procesin e përgatitjes së Planit të Biznesit 2023. Angazhimet në kompletimin e zotimeve nga klientët tanë dhe përcaktimi i potencialit për të krijuar të hyra nga transporti i mallrave dhe procesi në përgatitjen dhe finalizimin e proceseve deri në nënshkrim të Marrëveshjes së re të OSHP -së 2023 – 2027 kanë qenë intensive.

Për këto procese dhe prezantimi i të njëjtave në Planin e Biznesit 2023 mund të potencohen problemet e TRAINKOS Sh. A. për zhvillimin e aktivitetit të vetë në ofrimin e shërbimeve gjatë vitit që po e lejmë pas dhe ajo që pritet për vitin 2023 e tutje. Kjo bartë pasojat e ndërprerjes së pjesshme dhe në disa raste (me paralajmërim apo pa paralajmërim) edhe e plotë e linjës hekurudhore Fushë Kosovë – Hani i Elezit, konkretisht zbatimi i projektit "Modernizimi i Linjës së 10-të hekurudhore. Në periudhën raportuese përveç tjerave është edhe problemi me tunelet dhe urat dhe pa aftësia për vazhdim të punëve në një periudhë të pacaktuar!

Problem në vete është edhe ndërprerja e transportit për nevojat e partnerit / kompanisë me vite (që nga Shtatori 2007) funksionale – New Co Ferronikeli. Nga takimi i fundit me menaxhmentin e ri të kësaj kompanie kemi kuptuar se tendenca për fillimin e transportit vendorë në Shkurt 2023 krijon atmosferë optimiste dhe është përfshirë në planifikimet e kompanisë për vitin e ardhshëm, por informatat e fundit janë se me shqyrtimin e zbatimit të linjës për modernizim edhe viti 2023 do të mbetet i trishtë. Kjo nëse e kemi të prezantuar (jo zyrtarisht!) se punët në modernizimin e tuneleve dhe urave (sipas dinamikës së re!) do të zgjasin tërë vitin dhe mundësitë për rihapje të linjës do të jenë nga 10 – 15 ditë pas periudhave 45 – 50 ditore! Nga kjo që u kuptua dhe informatat e marra nuk mund të llogarisim në transportin ndërkombëtarë për New Co Feronikelin gjatë vitit 2023, kurse për transport vendorë duhet pritur dinamikën e përgatitjeve interne (sipas tyre!) për nevojat, dinamikën e plotësimit të planifikimeve dhe zgjidhjen e problemit me vagonët e tyre (ju ka skaduar afati i revizionit).

Gjatë periudhës raportuese janë diskutuar modalitete e vazhdimit të Marrëveshjes së OShP-së, konkretisht për atë pesë (5) vjeçare 2013 – 2027. Si rezultat i veprimeve është nënshkruar PROCESVERBALI mes Komisioneve të MMPHI dhe TRAINKOS më 29.12.2022. Nga kjo ka pasuar konfirmimi, analiza e draftit të Marrëveshjes për kompensimin e Obligimeve të Shërbimeve Publike për periudhën 2023 – 2027 më 18.01.2023. Buxheti i Kosovës për vitin 2023 ka të aprovuar shumën prej 1,910,275.00€ (MMPHI – 1,300,000.00€ dhe ME – 610,275.00€) për katër trena (Pejë – Prishtinë – Pejë) dhe mundësitë e lëshimit të trenave për Hanin e Elezit nëse linja do

të hapet. Kalkulimi i shpenzimeve dhe përcaktimi i humbje për të u mbuluar nga Buxheti i Kosovës bëhet sipas shpenzimit real në baza mujore.

Angazhimi i DZhB-së dhe entiteteve tjera përgjegjëse në kompani kanë shqyrtuar mundësitë për mbështetje nga potenciali i krijuara në relacione bilaterale me:

1. American Explorin and Mining LLC;
2. RubiRailtec – Southeast Europe;
3. Banka Botërore;
4. Konsullata e Kosovës në Gjermani;
5. Metro Istanbul A.S. dhe
6. Oda Ekonomike e Britanisë së Madhe në Kosovë.

DZhB ka përcjellë dhe është direkt i involvuar në proceset për politikat shtetërore që kanë të bëjnë me sektorin hekurudhorë, konkretisht me TRAINKOS-in dhe transportin e mallrave dhe udhëtarëve me hekurudhë. Ngjarjet / informatat më të rëndësishme janë:

1. Aprovimi i dokumentit "Strategjia e Transportit Multimodal 2023 – 2030;
2. Plani i Veprimit 2023 – 2025 për zbatimin e Strategjisë së Transportit Multimodal;
3. Koncept dokumenti për krijimin e Fondit Sovran të Republikës së Kosovës dhe
4. Takim virtual me përgjegjësi për proceset e përfshirjes së TRAINKOS-it nën ombrellën e Fondit Sovran.

Pjesëmarrja e TRAINKOS-it në iniciativat e BE-së për reforma në transportin hekurudhorë përmes Lëvizshmërisë së Qëndrueshme

Politikat e BE-së imponojnë reformat në transportin hekurudhorë përmes "Lëvizshmërisë së Qëndrueshme", për këtë përmes Sekretariatit për zbatimin e Traktatit për Transport janë shkëmbyer iniciativa dhe raporte përmbyllëse vjetore.

Gjatë periudhës raportuese kemi qenë bashkëpunues në përgatitjen e Samitit për Hekurudha të Shkëlqyeshme i cili do të mbahet më 21 Shkurt 2023 në Prishtinë nën patronatin e Ministrit të MMPHI –së, Z. Liburn Aliu.

Tregu i transportit hekurudhorë dhe problemet e TRAINKOS-it në realizimin e kërkesave për transportin e mallrave dhe udhëtarëve

Përkundër përsëritjes së vazhdueshme të kërkesës për pasurimin e flotës së mjeteve lëvizëse nuk kemi ndonjë përgjigje se a do të procedohet kërkesa e jonë e vazhdueshme për të i mundësuar TRAINKOS-it të i ketë në flotën e sajë mjetet lëvizëse të përshtatshme për plotësimin e kërkesave për transportin e mallrave dhe udhëtarëve. Problemet e mjeteve lëvizëse mbesin të hapura si për TU ashtu edhe për TM. Revizioni i vagonëve të udhëtarëve kërkon zgjidhje urgjente nëse e kemi parasysh periudhën e përfundimit të Marrëveshjes së OShP-së (Obligimi i Shërbimeve Publike)

2018 – 2022 dhe fazën për përgatitjet e Marrëveshjes së re pesë vjeçare. Këtu duhet të e kemi parasysh edhe skadimi i vlefshmërisë për futjen në operim të vagonëve të udhëtarëve pasi që revizioni pas vazhdimit dy herë ka gjashtë muaj ju kalon më 25.03.2023!? Flota e lokomotivave paraqet problem në vete për vëllimin minimal të transportit aktual e le më me fillimin e një fluksi të madh të mundshëm transporti të mallrave dhe udhëtarëve sipas paralajmërimeve. Sigurimi i stafit të ri dhe të trajnuar paraqet një sfidë në veti për kompaninë që duhet të konsiderohet për veprim gjithashtu.

Punët në përfundimin e proceseve për revizionin e vagonëve të udhëtarëve dhe lokomotivave sipas specifikimit në Planin e Biznesit 2023 duhet të realizohen me dinamikë të përshpejtuar nëse e kemi parasysh se tanimë kemi një Marrëveshje të OShP-së që e obligon kompaninë me sigurua faktorët teknik për realizimin e Marrëveshjes.

Planifikimi i domosdoshëm afatmesëm nga TRAINKOS-i për zhvillimet nga aspekti strategjik dhe gjendjes së krijuar duhet të ndodhë. Për këtë duhet të kërkohet mobilizim i stafit teknik por edhe tek përgjegjësit që janë bartës së politikave shtetërore në sektor, konkretisht në TRAINKOS Sh.A.

IX.2 Koordinimi i proceseve me MMPHI, ARH-në dhe Institucionet tjera relevante

Periudha raportuese Tetor – Dhjetor 2022 gjithashtu rezulton me angazhimin e vazhdueshëm në plotësimin e obligimeve në raport me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ARH-në, Ministrinë e Ekonomisë (ME), ESK (Enti Statistikorë i Kosovës) dhe KHAIA.

- Me Komisionin e MMPHI-së është punuar intensivisht për përfundimin e zbatimit të Marrëveshjes së OShP-së 2018 – 2022;
- Me Komisionin e përzgjedhur nga MMPHI është punuar intensivisht për përgatitjen dhe finalizimin e Marrëveshjesh së OShP-së 2023 – 2027;
- MMPHI-së ju janë përcjell statistikat e nevojshme për nevojat e Sekretariatit të Zbatimit të Traktatit për Transport;
- Departamenti i Rregullimit të Tregut në kuadër të ARH-së duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë që ka, është furnizuar me statistika zyrtare për transportin e mallrave dhe udhëtarëve në periudha të rregullta mujore;
- Me Departamentin e Sigurisë (ARH) është proceduar me kërkesën për tërheqjen e Autorizimit të mjeteve lëvizëse të cilat janë shitur si skrap;
- Jemi në vlugun e procedimit të kërkesës për fshirjen e mjeteve lëvizëse nga lista e NVR-së që janë shitur si skrap;
- Enti Statistikor i Kosovës është furnizuar me statistika zyrtare për transportin e mallrave dhe udhëtarëve në periudha të rregullta raportuese sipas kërkesës;

- Pjesëmarrje aktive me përfaqësim zyrtarë nga TRAINKOS-i në përgatitjen e koncept dokumentit për ndryshimin / amandamentimin e Ligjit për Hekurudhat e Kosovës (Nr. 04/L – 063).

IX.3 Aktivitet e Marketingut

TRAINKOS SH. A. edhe gjatë kësaj periudhe raportuese ka vazhduar me përmbushjen e obligimeve të dala nga Plani i Biznesit dhe Plani i Punës i Departamentit të Biznesit për monitorimin dhe vizitat e rregullta drejt klientëve të rregullt duke qenë afër tyre për shqyrtimin e çdo ankese apo kërkese që kanë në drejtim të kompanisë.

Po ashtu gjatë këtij nëntëmujori janë zhvilluar kontakte dhe takime me klient potencial, me të cilët janë shqyrtuar mundësit e realizimit të transportit me hekurudhë.

KËRKESAT DHE OFERTAT E TRANSPORTIT

Më poshtë do të prezantojmë në formë tabelore kërkesat dhe ofertat e transportit të mallrave konvencionale dhe me kontejnerë të pranuara përgjatë periudhës **Tetor - Dhjetor 2022.** Sektori i Marketingut ka pranuar kërkesat për ofertë transporti si më poshtë:

Nr.	Emri i kompanisë	Relacioni	Lloji i mallit	Sasia
1.	**Trio Construction**	Hani i Elezit – Miradi / Kosovë	Cement refuz	12 000 t
2.	**See Regional Advisor**	Hani i Elezit - Porti i Selanikut	Thëngjill linjit	1 000 000 t
3.	**See Regional Advisor**	KEK – Hani i Elezit	Thëngjill linjit	1 000 000 t
4.	**D Logistic Sh.p.k.**	Hani i Elezit - Miradi/Kosovë	Kontejnerë 20&40 Ft	160 Copë
5.	**D Logistic Sh.p.k.**	Hani i Elezit - Pejë/Kosovë	Kontejnerë 20&40 Ft	160 Copë

OFERTAT E DËRGUARA DREJT KLIENTËVE BRENDA RRJETIT KU OPERON TRAINKOS SH. A. JANË:

Nr.	Ofertuesi	Relacioni	Lloji i mallit	Sasia	Çmimi
1.	**Trainkos Sh. A.**	Hani i Elezit - Miradi	Cement refuz	12 000 t	**5.30 €/t**
2.	**Fershped AD**	Hani i Elezit - Porti i Selanikut	Thëngjill linjit	7 000 t	**15.00 €/t**
3.	**Fershped AD**	KEK - Hani i Elezit	Thëngjill linjit	704 t	**5.70 €/t**
4.	**Trainkos Sh. A.**	Hani i Elezit - Miradi	Kontejner 20 Ft (F/E)	1000 t	**130 €/Cntr**
5.	**Trainkos Sh. A.**	Hani i Elezit - Pejë	Kontejner 20 Ft (F/E)	1000 t	**5.17 €/t**

Në bazë të të dhënave të prezantuara më lartë, Sektori i Marketingut gjatë periudhës tetor – dhjetor 2022 është angazhuar maksimalisht për të realizuar aktivitetet e parapara në Planin Vjetor të Sektorit të Marketingut dhe po ashtu objektivat e përcaktuara nga Plani i Biznesit për vitin 2022.

Sektori i Marketingut ka realizuar kryesisht aktivitetet të cilat kanë të bëjnë me përpilimin e kontratave të transportit, përpunimin e analizës së buxhetit të të hyrave për klientët e rregull, kemi mbajtur kontakte me klientë dhe me partnerë vendor dhe ndërkombëtarë, kemi pranuar kërkesa të transportit të cilat i kemi proceduar drejt të gjithë partnerëve tanë vendor dhe ndërkombëtarë si dhe procedimin e ofertave drejt të gjithë klientëve. Po ashtu jemi marrë edhe me përgatitjen e ofertave konkrete të udhëtimit me tren për Transport të Udhëtarëve, si dhe përgatitjen e ofertave speciale për udhëtime të veçanta.

Ndërsa sa i përket pjesëmarrjes tonë në fushën promovuese ne nuk kemi qenë prezent në shumë kanale të marketingut për shkak të kostove shumë të larta dhe kemi shpenzuar në mënyrë sa me optimale të mundshme pasi që edhe kërkesa e DBZH-së ka qenë që të gjitha shpenzimet e Sektorit të Marketingut të minimizohen për shkak të gjendjes financiare jo të mirë në nivel të kompanisë.

IX.4 Raportimi i rregullt në Asociacionet Hekurudhore dhe Sekretariatin për zbatimin e Traktatit për Transport

Periudha raportuese ka rezultuar me veprime konkrete nga përgjegjësit e Sekretariatit për Zbatimin e Traktatit për Transport. Nga kontaktet, veprimet e ndodhura dhe pjesëmarrja në takime të organizuara kemi prezantuar gjendjen dhe nevojat e kompanisë.

IX.5 Shqyrtimi i mundësive për kryerjen e veprimtarisë – shpedicion për klientët e TRAINKOS-it dhe përfshirja e gamës së veprimtarisë sipas mundësisë për shqyrtim – Plani i Biznesit 2023

TRAINKOS Sh. A. me Certifikatë të regjistrimit të biznesit ka të drejtë që përveç transportit me hekurudhë të ofroj edhe shërbime tjera siç janë: Transport tjetër i rregullt tokësor i udhëtarëve, konstruktim dhe riparim të mjeteve lëvizëse hekurudhore, transport tokësor rrugor i udhëtarëve, transporti rrugor i mallrave, transporti detar dhe bregdetar, transport në rrugët e brendshme, ngarkim – shkarkim i peshave, magazinim i mallit, veprimtaritë tjera përcjellëse të transporti tokësor dhe veprimtari e agjencive të tjera të transportit. Zhvillimi i aktivitetit të shpedicionit që nga ndarja e Hekurudhave të Kosovës (viti 2011) ka mbetur në fazën e përgatitjes së proceseve fillestare të zhvillimit të veprimtarisë dhe pret pëlqimin e stafit menaxhues dhe aprovimin nga Bordi i Drejtorëve për të filluar me këtë veprimtari. Duhet të e kemi parasysh se përfshirja e kësaj veprimtarie në shërbimet që ofron TRAINKOS-i do të mundësonte një qasje më të kompletuar në raport me klientët ekzistues dhe klientët e ri potencial në të ardhmen për transportin e mallrave dhe udhëtarëve.

X. SFIDAT KRYESORE GJATË PERIUDHËS TETOR – DHJETOR 2022 DHE VEPRIMET PËR TË ARDHMEN

Gjatë periudhës raportuese, si kompani vazhdojmë të ballafaqohemi me sfidat si në vijim:

1. Ballafaqimi në vazhdimësi me ndërprerje të linjës Fushë Kosovë – Hani i Elezit gjatë Modernizimit të këtij sesioni. Vonesat në realizimin e projektit "Modernizimi i Linjës së 10-të hekurudhore" si infrastrukturë bazë që bënë lidhjen me pjesën tjetër të Evropës dhe Porte detare;
2. Gjendja jo e mirë e mjeteve lëvizëse për shkak të vjetërisë së tyre dhe nevoja për mjete lëvizëse adekuate për plotësimin e kërkesave për transportin e mallrave dhe udhëtarëve;
3. Restrikcionet e vendosura nga Maqedonia Veriore për transport të minimum 6 vagonëve që vijnë në drejtim të Kosovës;
4. Mungesa e ligjit për sigurinë në komunikacionin hekurudhor;
5. Nevojitet ndryshimi / amandamentimi i Ligjit për Hekurudhat;
6. Proceset e shumta gjyqësore të trashëguara nga ish-Hekurudhat e Kosovës;
7. Mos funksionimi i të gjitha linjave hekurudhore;
5. Mos zbatimi i bazës ligjore dhe mungesa e legjislacionit sekondar në sektorin e transportit dhe lejimi i konkurrencës jo lojale;
6. Licencimi dhe futja në treg e operatorit hekurudhor privat, pa ndonjë analizë të mirëfilltë të tregut nga ana e institucioneve relevante dhe rreziku i regjistrimit të pretendentëve tjerë;
10. Neglizhenca e institucioneve relevante të cilat veprojnë në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës në inkorporimin e operatorit shtetërorë në planifikimet strategjike për zhvillim industrial të vendit;
11. Mosha mesatare e lartë e personelit ekzekutiv, nevoja për staf të kualifikuar që mund të përcjell trendin e zhvillimit të reformave / zhvillimeve në sektor;

Duke pasur parasysh që sfidat e lartcekura janë të natyrave të ndryshme dhe kërkojnë përkrahje edhe nga shumë institucione relevante, kompania është munduar në vazhdimësi që këto sfida / probleme t'i paraqes dhe të kërkojë zgjidhje / mbështetje. Por ka qenë e pamundur arritja e rezultateve pozitive duke rezultuar edhe me mos përmirësimin e përgjithshëm të kompanisë.

Përkushtimi mbetet dhe do të insistojmë që të gjitha këto probleme të trajtohen nga institucionet dhe faktorët tjerë relevant në mënyrë që të marrim zgjidhjet e duhura, me qëllim të zhvillimit të ndërmarrjes si aset shtetëror.

Për këto sfida të precizuara më lart përgjegjësit në kompaninë Hekurudhat e Kosovës - TRAINKOS Sh. A. sipas planifikimeve mbesin të përkushtuar në angazhimin maksimal në realizimin e objektivave të parashtruara.

Fushë Kosovë,
Janar 2023

Gelor SHALA
Kryeshef Ekzekutiv